



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 47/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë, parashtruar kundër subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore, Nominimi dhe emërimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 12.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë, e parashtruar kundër subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore, Nominimi dhe emërimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07.06.2026.

A r s y e t i m

Me datë 10.06.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lista Serbe ku pretendohet se më datë 09.06.2026, gjatë kohës kur po vazhdonte numërimi i votave në qendrat komunale për numërimin e votave, në momentin kur ende nuk dihen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 07.06.2026, përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Nenad Rashiq, ka shkelur rëndë Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme dhe rregullat zgjedhore, duke organizuar një konferencë për media të subjektit të tij politik duke përdorur lokalet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në krye të së cilës ai ndodhet. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se pyetja e gazetarit dhe përgjigja e Rashiqit janë provë se ai ishte i vetëdijshëm për veprimet e tij: "Në pyetjen se pse konferenca e tij po mbahet në ndërtesën e Ministrisë, nëse ai flet si përfaqësues i një partie, Rashiq thotë se " *jo është për shkak se unë jam ende ministër në mandat teknik. Besoj se nuk do ma mbani për keq nëse i kam keqpërdorur këto zyra, sepse këtu ka shumë më shumë vend për ju, sesa në partinë tonë të vogël*". Në këtë mënyrë, ankuesi

pretendon se Nenad Rashiq ka keqpërdorur pozitën e tij dhe gjatë fjalës së tij, pavarësisht paralajmërimeve të gazetarëve se po përdor lokalet e një institucioni publik për partinë e tij politike, nuk e ka mohuar se është i vetëdijshëm se po e bën këtë, duke pranuar kështu para publikut shkeljen e ligjit dhe të rregullave zgjedhore prandaj kjo sjellje sipas parashtruesit të ankesës është e dënueshme sipas rregulloreve vendore, por është gjithashtu në kundërshtim me standardet demokratike. Përdorimi i ambienteve të një institucioni publik me simbole zyrtare në momentin kur po numërohen votat përbën një rrethanë rënduese gjatë shkeljes së rregulloreve, sepse mund të ndikojë te personat që janë pjesë e procesit zgjedhor. Përveç Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nr. 07/L-228, Nenad Rashiq ka shkelur edhe nenin 211 të Kodit Penal të Kosovës 04/L-082, i cili lidhet me keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë procesit zgjedhor. Andaj, subjekti politik Lista Serbe kërkon nga PZAP që ta vërtetoj se përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak Nenad Rashiq ka kryer shkelje të ligjit dhe të rregullave zgjedhore dhe t'i shqiptoj sanksionet e duhura.

Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun e artikullit mediatik për konferencën: <https://kossev.info/rasic-vecina-nasih-glasova-stigla-je-iz-srpskih-sredina-raste-nam-podrskana-severu/>

Në përgjigje në ankesë nga subjekti politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, është theksuar se, ankesa në fjalë është formalisht e parregullt dhe ligjërisht kontradiktore. Përkatësisht, parashtruesi i ankesës në formularin zyrtar për parashtrimin e ankesës ka shënuar kategorinë "Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve", ndërsa nga përmbajtja e ankesës shihet padyshim se pretendimet nuk lidhen me emërimin apo nominimin e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve, por me shkeljen e pretenduar të dispozitave të Kodit të Sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidatëve. Midis kategorisë së shënuar të ankesës dhe pretendimeve të përfshira në ankesë nuk ekziston asnjë lidhje ligjore apo faktike. Tutje, në përgjigje sqarohet se parashtruesi i ankesës e bazon pretendimin e tij vetëm në një artikull mediatik të portalit KoSSev dhe interpretimeve personale të përmbajtjes së atij artikulli dhe si provë nuk është dorëzuar asnjë dokument zyrtar, procesverbal, fotografi, videoincizim as ndonjë provë tjetër që do të vërtetonte pretendimet për keqpërdorim të pretenduar të burimeve publike dhe se nga vetë artikulli që parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur, rezulton se konferenca për media është mbajtur më 09.06.2026, pra pas dy ditësh votimi dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Me tutje ka shtuar se, nuk ekziston mundësia që konferenca e përmendur të ketë ndikuar te votuesit, vullnetin zgjedhor të qytetarëve apo rezultatin e zgjedhjeve, gjë që përbën një nga elementet kryesore për ekzistimin e një shkelje zgjedhore dhe se ankuesi nuk ka provuar se janë përdorur mjete buxhetore publike për qëllime fushate, se zyrtarët e Ministrisë kanë marrë pjesë në aktivitete politike, se ndonjë nga votuesit ka qenë nën ndikimin e veprimit të pretenduar, se ka ndodhur ndonjë dëmtim i procesit zgjedhor por nga artikulli i bashkangjitur rezulton se Nenad Rashiq ka vepruar si ministër në mandat teknik, gjë që në vetvete nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore as provë të keqpërdorimit të burimeve publike, por si bartës i një institucioni. Andaj subjekti politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak kërkon nga PZAP që ta refuzojë ankesën si formalisht të parregullt dhe të palejueshme për shkak të

kategorisë së gabuar të ankesës dhe mospërputhjes midis formularit dhe përmbajtjes së ankesës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lista Serbe, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe as të Rregullave zgjedhore që rregullojnë procesin zgjedhor, konkretisht procesin e numërimit të votave. Paneli vlerëson se, pavarësisht se ankuesi si shkelje të pretenduar nga përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, në formularin e ankesës ka nënvizuar si shkelje “Nominimi dhe emërimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimeve”, mirëpo Paneli ka vlerësuar përmbajtjen e ankesës, nga e cila shihet se ankuesi ka pretenduar se, përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Nenad Rashiq, ka shkelur Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme dhe rregullat zgjedhore, duke organizuar një Konferencë për media me datë 09.06.2026 të subjektit të tij politik duke përdorur lokalet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në krye të së cilës ai ndodhet dhe se Konferencën për media e ka mbajtur gjatë kohës kur po vazhdonte numërimi i votave në Qendrat Komunale për Numërimin e Votave, kur ende nuk dihen rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare të mbajtura më 07.06.2026.

Paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në ankesë në këtë rast, linkut të bashkangjitur nga parashtruesi i ankesës, vlerëson se, pala ankuese nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se, mbajta e Konferencës për media me datë 09.06.2026, 2 (dy) ditë pas mbajtjes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, përbën shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nr. 08/L-228 dhe Rregullave Zgjedhore, për arsye se, Konferenca për media është mbajtur pas përfundimit të fushatës zgjedhore, që do të thotë se nuk përbën shkelje të fushatës zgjedhore. Po ashtu, pala ankuese nuk ka paraqitur prova bindëse se mbajtja e Konferencës për media nga përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Nenad Rashiq, do të ketë ndikim në procesin e numërimit të votave në QKN dhe të personat që janë pjesë e procesit zgjedhor, sepse në QKN gjatë numërimit të votave janë prezent Komisionerë dhe vëzhgues të të gjitha subjekteve politike, përfshirë edhe ata të Listës Serbe, e që të njëjtit nuk kanë paraqitur ndonjë vërejtje lidhur me pretendimet në ankesë.

Në rastin konkret Paneli, vlerëson se, mbajta e Konferencës për media nga përfaqësuesi i subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Nenad Rashiq, është bërë pas përfundimit të periudhës së fushatës zgjedhore, në një fazë kur votimi tashmë është i përmbyllur dhe procesi ndodhet në fazën e administrimit dhe numërimit të votave, deklarimi i dhënë nga Nenad Rashiq, nuk mund të ndikoj me as tek votuesit dhe as tek rezultati i

zgjedhjeve, për këtë arsye Paneli ka vendosur që ankesën e ankuesit të refuzoj si të pabazuar.

Po ashtu Paneli vlerëson se, sa i përket pretendimit se, i njëjti ka shkelur edhe nenin 211 të Kodit Penal të Kosovës 04/L-082, i cili lidhet me keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë procesit zgjedhor, Paneli gjen se, kjo nuk bie në domenin e vendimmarrjes nga ana e Panelit, por e njëjta mund të vlerësohet nga ana e Organeve tjera përkatëse që ndërliohen eventualisht me ekzistimin apo jo të elementëve të veprës penale.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.47/2026, datë 12.06.2026

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.